



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA

**Thirrje për aplikim:**

**A. 1 Specialist Finance pranë AKZM Tiranë**

**Nga:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)  
Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë,  
www.turizmi.gov.al

**Kontakte:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)  
e-mail: info@akzm.gov.al

**Datë:** 13.04.2023

**Titujt vakant:**

A. 1 Specialist Finance pranë AKZM Tiranë për 8 muaj e 12 ditë  
(19 Prill – 31 Dhjetor 2023)

**Referenca.:** Rezultati 5, Aktiviteti 5.1 (Pozicioni 1A) sipas projektit të financuar nga PONT dhe zbatuar nga AKZM.

**1. Hyrje**

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë,

institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: [www.pont.org](http://www.pont.org).

Zbatimi i grantit do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2023. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë (PKASH) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë (PKASH).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Kukës dhe Shkodër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

## **2. Subjekti i aplikimit**

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për PK Alpet e Shqipërisë (PKASH), PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Shkodër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë në AKZM në Tiranë dhe në AdZM Kukës dhe AdZM Shkodër.

AKZM tani fton kandidatët e kualifikuar për pozicionet e mëposhtme të punës:

- A. 1 Specialist Finance pranë AKZM Tiranë

të paraqesin shprehjen e tyre të interesit dhe të dorëzojnë CV-të e tyre dhe dokumentet e tjera mbështetëse siç janë renditur më poshtë në paragrafin 3.

## **3. Kushtet për aplikim**

Personat e interesuar duhet të japin informacionin e tyre duke demonstruar se kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet sipas kërkesave të ToR-ve, përmes CV-së së tyre dhe dokumenteve të tjera mbështetëse si kopjet e diplomës; kopjet e certifikatave për kurset e trajnimit të ndjekura, studime të tjera pasuniversitare, nëse ka.

- Për pozicionet e shpallura, gjuha e CV-së duhet të jetë shqip dhe CV-ja të jetë e firmosur dhe të tregojë pozicionin për të cilin aplikon kandidati.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve të sipërpërmendura duhet të jetë brenda datës 18 Prill 2023 – ora 14.00.
- Dokumentet duhet të dorëzohen me postë të rregullt ose personalisht në AKZM: (Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Pozicioni \_\_\_\_\_). Vëmendje Oficeri i Komunikimit, Adresa: Blvd.Dëshmorët e Kombit, Nr. 1, Tiranë) ose me e-mail në adresën: [info@akzm.gov.al](mailto:info@akzm.gov.al).

- Pozicioni për të cilin kandidati po aplikon duhet të shënohet në zarf dhe në subjektin e aplikimit me email.
- Dokumentet e marra pas afatit dhe jo sipas kërkesave të mësipërme, nuk do të merren në konsideratë dhe do të përjashtohen nga konkurrimi.
- Modeli i CV-së është i disponueshëm në Aneksin 2 të kësaj ftese (Ju lutemi referojuni: Aneksit: 1A për Termat e Referencës (ToRs) dhe Aneksit 2 për formularin e CV-së)
- Në rast të shpalljes fitues, shërbimi do të fillojë menjëherë pas nënshkrimit të kontratës nga të gjitha palët.

**Me respekt,**  
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura

## Aneksi 1A TERMAT E REFERENCËS

### 1A. 1 Specialist Finance pranë AKZM Tiranë

<b>Autoriteti kontraktues:</b>	AKZM
<b>Burimi i financimit:</b>	Prespa Ohrid Nature Trust PONT
<b>Referenca e buxhetit:</b>	Rezultati 5, Aktiviteti 5.1
<b>Detyra e ekspertit:</b>	1 Specialist Finance pranë AKZM, Tiranë
<b>Kohëzgjatja:</b>	8 muaj e 12 ditë nga data e kontraktimit, përkohësisht 19 Prill 2023 – 31 Dhjetor 2023
<b>Input:</b>	Me kohë të plotë për 8 muaj e 12 ditë.
<b>Tipi i kontratës:</b>	Kontratë shërbimi 8 muaj e 12 ditë.
<b>Vendndodhja:</b>	Eksperti do të qëndrojë në ambientet e AKZM-së në Tiranë.
<b>Reporton tek:</b>	Drejtori i AKZM-së dhe Shefi i Sektorit të Financave.

#### Hyrje:

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është autoriteti qeveritar përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri. AKZM operon nëpërmjet 12 Administratave Rajonale për Zonat e Mbrojtura (AdZM) të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për menaxhimin në terren dhe monitorimin e zonave të mbrojtura brenda territorit të rajonit të tyre. AdZM përbëhet kryesisht nga një sektor monitorimi dhe një sektor menaxhimi i mbështetur nga një numër rojesh të dedikuar për çdo zonë të mbrojtur dhe kryesisht përgjegjës për patrullimin në terren.

Prespa Ohrid Nature Trust (PONT) është një fond mirëbesimi ndërkufitar i krijuar në vitin 2015 nga Fondacioni MAVA dhe nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me misionin “Ruajtja e natyrës për një të ardhme të qëndrueshme përmes krijimit të partneriteteve dhe mbështetjes financiare afatgjatë”. PONT zbaton misionin e tij nëpërmjet dy programeve kryesore të granteve: (1) bashkëfinancimi i kostove operacionale të Zonave të Mbrojtura dhe (2) bashkëfinancimi i punës së Aktorëve Mjedisorë. Aktorët Mjedisorë përfshijnë organizatat jofitimprurëse (OJF) me fokus mbrojtjen e natyrës, bashkitë, institucionet shkencore dhe akademike. Për më shumë informacion ju lutemi na vizitoni në: [www.pont.org](http://www.pont.org).

Zbatimi i grantit do të jetë për 12 muaj duke filluar nga Janar 2023. Qëllimi i grantit është bashkëfinancimi i kostove operacionale për Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë (PKASH) në Shqipëri në përputhje me Planin e Menaxhimit.

Kjo për të kontribuar në ruajtjen e biodiversitetit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës të banorëve në Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë (PKASH).

Granti nga PONT i jepet Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) në bashkëpunim me Agjencinë Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdZM) në Kukës dhe Shkodër me përgjegjësinë e planifikimit dhe drejtimit të zbatimit të masave të projektit në nivel vendor si dhe vendosjen e lidhjeve me aktorët lokalë.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve për zbatimin e planit operacional për PK Alpet e Shqipërisë (PKASH), PONT ka dhënë një grant për AdZM Kukës dhe AdZM Shkodër, nëpërmjet AKZM, duke përfshirë financimin për punësimin e personelit shtesë. AKZM po mbështet punësimin e stafit, menaxhimin dhe ngritjen e kapaciteteve të personelit të sapo punësuar.

### **Objektivi i punës:**

Sipas strukturës aktuale organizative dhe rregulloreve funksionale të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të gjitha aktivitetet në lidhje me menaxhimin financiar dhe burimet njerëzore trajtohen në nivelin qendror. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që të gjitha aktivitetet ndodhin në nivelin rajonal është e nevojshme që të sigurohet mbështetje dhe koordinim për AdZM-të (Dibër, Kukës, Shkodër) për t'u marrë me këto çështje, për këtë qëllim një Specialist Financiar po vendoset në AKZM Tiranë me financim nga PONT.

Nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së dhe Shefit të Sektorit të Financave, specialisti do t'i sigurojë mbështetje AdZM-ve (Dibër, Kukës, Shkodër) në zhvillimin e planeve dhe programeve të lidhura me buxhetin dhe do të sigurojë informacion të azhurnuar për AKZM-në ose / dhe donatorë të tjerë për çështje të lidhura me financimin. Specialisti do të ndihmojë në mbajtjen e komunikimit të vazhdueshëm me Drejtorinë e Financave dhe Shërbimeve të Brendshme në AKZM dhe do të mbështesë shkëmbimin e informacionit në lidhje me hartimin e buxheve. Specialisti do të sigurojë mbështetje për Specialistët e Projekteve pranë AdZM-ve (Dibër, Kukës, Shkodër) për çështje që lidhen me menaxhimin e projektit, si dhe çështje të tjera që lidhen me funksionimin e mirë të aktivitetit të AdZM-ve në lidhje me kërkesat administrative të AKZM-së në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe kërkesat e PONT.

Eksperti do të punojë ngushtë me Drejtorin e Përgjithshëm të AKZM-së dhe Shefin e Sektorit të Financave dhe Specialistët e Projekteve pranë AdZM-ve (Dibër, Kukës, Shkodër).

**Detyrat e përgjithshme të një Specialisti Financiar me kohë të plotë përkojnë me përshkrimin e detyrave të Specialistit Financiar pranë AKZM-së sipas Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe funksionimin e AKZM-së dhe AdZM-ve:**

### **Detyrat specifike:**

Përgjegjësitë e Specialist Financiar përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në detyrat e mëposhtme:

- Kontribuon në zbatimin e planeve të punës vjetore dhe mujore të AKZM-së, në përgjithësi.

- Kontribuon në parashikimin e kostove dhe buxhetin sipas aktiviteteve të parashikuara në planet vjetore të AdZM-ve (Dibër, Kukës, Shkodër). Mbështet parashikimin e e buxhetit të kërkuar për zbatimin e planit operacional vjetor.
  - Mbështet raportimin mujor të AdZM-ve (Dibër, Kukës, Shkodër) në përputhje me kërkesat e AKZM-së dhe donatorëve (transferimi mujor i dokumenteve përkatëse financiare dhe kontraktuale, përgatitja mujore e fletëve të kohës së punës (Timesheet/TS), kontabiliteti mujor dhe menaxhimi financiar, raportimi në përputhje me kërkesat e PONT-it).
  - Mbështetje për aktivitetet e tjera financiare / administruese të AdZM-ve (p.sh. sistem regjistrimi efektiv, sistemi i zyrave, monitorimi dhe raportimi i aktiviteteve të prokurimit).
  - Sipas kërkesës, mbështet për krijimin e një sistemi të ndihmës për zyra, burime njerëzore dhe logjistike për AKZM-në.
- Kryen çdo detyrë tjetër në përputhje me funksionin e pozicionit në koordinim të ngushtë me Drejtorin e AKZM-së dhe Përgjegjësën e Sektorit të Financave të AKZM-së.
- Pas përcaktimeve nga AKZM me marrjen e detyrës do të hartohet një listë me detyra të hollësishme për 12 muajt e 2023 dhe një plan personal mujor i punës, i cili do të miratohet nga Drejtori i AKZM-së dhe Përgjegjësi i Sektorit të Financës.

### **Kërkesa të përgjithshme:**

- Demonstron integritet, duke promovuar vlerat dhe standardet etike të AKZM-së.
- Paraqet ndjeshmëri dhe përshtatje kulturore, gjinore, fetare, racore, të kombësisë dhe moshës.
- Aftësi për të organizuar dhe kryer me saktësi detyra të shumta, duke vendosur prioritete dhe duke marrë në konsideratë detyra të veçanta, ndërprerje të shpeshta, afate, burime të disponueshme dhe marrëdhënie të shumta raportimi.
- Aftësi për të planifikuar, koordinuar dhe organizuar ngarkesën e punës, ndërsa mbetet i vetëdijshëm për ndryshimin e përparësive dhe afateve.
- Përvojë në krijimin, ndërtimin dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me stafin, vizitorët, komunitetin lokal dhe palët e tjera të interesuara për të lehtësuar ofrimin e mbështetjes.
- Aftësi për të identifikuar mundësitë e ngritjes së kapaciteteve për stafin.
- Ndjeshmëri dhe përgjegjshmëri ndaj të gjithë stafit dhe palëve të tjera të interesuara.
- Aftësi për të mbështetur zbatimin e aktiviteteve, qasjeve dhe ideve të reja dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljes/qëndrimit të stafit.
- Ndjekja e mundësive të zhvillimit profesional, të ofruara në kuadrin e mbështetjes së projektit PONT, d.m.th. trajnime për vendin e punës, masa për ndërtimin e kapaciteteve etj.

### **Aftësitë vetë-menaxhuese:**

- Përqendrohet në rezultate për AKZM-së/AdZM-ve,
- Qasje në mënyrë të vazhdueshme të punës me energji dhe një qëndrim pozitiv, konstruktiv,
- Udhëheqje dhe motivim,
- Mbetet i qetë, në kontroll dhe me humor të mirë edhe nën presion,
- Demonstron pranim ndaj ndryshimeve dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetet,
- I përgjigjet pozitivisht reagimeve kritike dhe pikëpamjeve të ndryshme,
- Kërkon reagime nga stafi për ndikimin e sjelljes së tij / saj.

**Kualifikimet:**

- Minimumi diplomë universitare Bachelor, përbën prioritet Master Universitar në Kontabilitet/Finance, Administrim Biznesi ose fusha të ngjashme.
- Përvojë e mëparshme në fushën e menaxhimit të projekteve.
- Njohuri të mira të gjuhës angleze (me shkrim dhe me gojë).
- Njohuri të mira të programeve windows (word, Excel, PowerPoint dhe Microsoft Outlook) dhe për të përdorur internetin. Përvoja e mëparshme e punës në lidhje me detyrat financiare, administrative, sekretariale.
- Aftësi të shkëlqyera ndërnjerëzore dhe komunikuese.
- Aftësia për të punuar në mënyrë proaktive
- Aftësia për të operuar në një mjedis ndërkulturor që kërkon fleksibilitet. Sjellje dhe pamje profesionale.
- Shumë i organizuar dhe i aftë të punojë mirë në një ekip.

### Aneksi 2 CV form

**Pozicioni:** *Shënoni pozicionin për të cilin aplikoni*

### CURRICULUM VITAE

1. Mbiemri: xxx  
 2. Emri: xx  
 3. Ditëlindja: xx  
 4. Kombësia: xx  
 5. Gjendja civile: xx  
 6. E-mail: xx  
 7. Celular: xx  
 8. Edukimi:

Data (nga – deri)	Institucioni	Diplomat:
Xxx	X	X
Xxx	X	X
Xx	X	x

9. Aftësitë në gjuhët e huaja: Vlerësoni nivelin nga 1 deri në 5 (5 – shkëlqyeshëm; 1 – bazë)

Gjuha	Të lexuarit	Të folurit	Të shkruarit
X	Gjuha amtare		
X			
X			
X			

10. Anëtarësimi në grupe profesionale: / xxx

11. Aftësi të tjera:

12. Pozicioni aktual: xxx

13. Vite në këtë pozicion: x years

14. Aftësi kyçe:

- *Përshkruani në detaje*

15. Eksperienca specifike në rajon:

Shteti	Data nga – deri
XXX	Muaji/Viti



### 16. Eksperienca profesionale

Data nga – deri	Vendi	Kompania	Pozicioni	Përshkrimi
xxx - aktualisht	xx	xx	x	<i>Përshkruani me detaje</i>
xxx - xxxx				•
xxx - xxxx				•
xxx - xxxxx				•
xxx - xxx				•

### 17. Informacione të tjera:

data	Titulli i trajnimit/workshopit	Vendi, institucioni
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	xxx
xxx	Xxx	
xxx	Xxx	
xxx	Xxx	

### 18. Publikime:

Autori (Viti)– Titulli, Gazeta/shtëpia botuese